



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 2764/Prot
167

Tiranë, më 25.11.2024

V E N D I M

Nr. 29 datë 25.11.2024

“PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL TË SIPËRMARRËSIT ONE ALBANIA SH.A PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË BREZIT 3400-3800 MHZ (3420-3540 MHZ, SPEKTËR I PAÇIFTUAR)”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtare
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 25.11.2024, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr. 7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Miratimin e Autorizimit Individual të sipërmarrësit One Albania sh.a për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz (3420-3540 MHz, spektër i paçiftuar)”.**

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 66, 67, 69, 70 dhe 71, të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Pikat 19.2 dhe 19.3 të kreut III dhe pika 1 e Kreut V, të VKM nr. 1252, datë 10.09.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënie e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar;
3. VKM nr. 1187 datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (PKF).
4. Planin e Përdorimit të Frekuencave (PPF), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 7 datë 06.09.2023.

5. VKM nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe të planit të veprimit”.
6. Rregullore nr. 30, datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”;
7. Rregullore e brendshme e Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të KD të AKEP, e ndryshuar.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacioni shpjegues;
- Projektvendim i KD, i formatuar dhe arsyetuar;
- VKD nr. 28 datë 12.11.2024 “Për miratimin e raportit përmbledhës të KVO-së, Njoftimin e Fituesit dhe Botimin e Fituesit, të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400 - 3800 MHz (3.5 GHz)”.

Si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Me vendimin nr. 28 datë 12.11.2024, Këshilli Drejtues i AKEP, ka miratuar:
 - a. Raportin Përmbledhës të KVO, me nr. 2264/59 prot., datë 04.11.2024.
 - b. Njoftimin Botimin e Fituesit, shoqëria One Albania sh.a, për bllokun A - 3420-3500 MHz (sasi spektri 80 MHz) me çmim 3,624,000 (tre milion e gjashtëqind e njëzet e katër mijë) Euro dhe bllokun D - brenda brezit 3500-3720 MHz (sasi spektri 40 MHz), të frekuencave të brezit 3400-3800 MHz, me çmim 1,812,000 (një milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë) Euro;
2. Njoftimi dhe botimi i fituesit i është dërguar sipërmarrësit One Albania sh.a me shkresën nr. 2264/63 prot. datë 12.11.2024.
3. Bazuar në pikat 14.2, 14.3, 17.1, 17.2 dhe 21 të dokumentit të tenderit, miratuar me VKD nr. 20 datë 27.08.2024, sipërmarrësi i shpallur fitues, përpara pajisjes me Autorizim Individual, duhet të shlyejë të gjitha pagesat e përcaktuara në dokumentin e tenderit, brenda 7 ditëve për Buxhetin e Shtetit dhe brenda 10 ditëve nga njoftimi i fituesit. Në dokumentin e tenderit, përcaktohet se çmimi i ofertës, i ofruar nga ofertuesi që fiton të drejtën e përdorimit të brezit të frekuencave të tenderuara, derdhet prej tij në Buxhetin e Shtetit, si pagesë me këste:
 - Kësti i parë: 50 %: brenda 7 ditëve nga marrja e Njoftimit të Fituesit.
 - Kësti i dytë: 50 %: 6 muaj pas dhënies së Autorizimit Individual.
- a. Sipërmarrësi One Albania sh.a, në datën 14.11.2024, ka shlyer në llogarinë e Qeverisë Shqiptare, këstin e parë prej 50 %, në vlerën 2,718,000 Euro.
- b. Sipërmarrësi One Albania sh.a, në datën 15.11.2024, ka shlyer pagesat ndaj AKEP, sipas faturës nr. 1225 datë 12.11.2024.

Me shkresën nr. 2264/66 prot. datë 15.11.2024, sipërmarrësi One Albania sh.a, ka njoftuar në AKEP, shlyerjen e faturave për pagesat e sipërcituara.

4. Autorizimi Individual i paraqitur bashkëlidhur projekt-vendimit, është i njëjti me Autorizimin Individual të Shtojcës nr. 20, të dokumentit të tenderit.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës gj), të nenit 8, pikës 1, të nenit 115 të Ligjit nr. 9918/2008, pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr. 34/2017, K.Pr.A, pikës 2.3, të Kreut III dhe Kreut V, të VKM nr. 1252/2008, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, duke çmuar rëndësinë e miratimit të autorizimit individual për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz, ndërtimin e rrjetit të lëvizshëm me këto frekuenca dhe ofrimin nëpërmjet tij të shërbimeve të komunikimeve elektronike, interesin publik dhe përputhshmërinë ligjore, Këshilli Drejtues i AKEP;

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit One Albania sh.a për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz (3420-3540 MHz, spektër i paçiftuar), sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Ky Autorizim Individual jepet me afatin maksimal për 15 vjet.
3. Ky Autorizim Individual fillon efektet e tij në datën 25.11.2024 dhe përfundon vlefshmërinë në datën 25.11.2039.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të AKEP, www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Tomi Frashëri



Anëtar

Edlira Dvorani



Anëtar

Lorenc Bako



Anëtar

Bleron Dokle



Anëtar

Armer Juka

